



Intervistë e Ministrit Sadri Ferati

Decentralizimi është proces i integritimeve evropiane

Parakushti kryesor që do të ndikojë drejtpërdrejt në rezultatet tona, jo në kompetenca, por në rezultatet tona, është vetë definimi i statusit final të Kosovës që është pavarësia.

Pavarësia e Kosovës është kusht ligjor me kryerjen e të gjitha përgatitjeve në mënyrë që menjëherë pas statusit pritët të implementohet pakoja e presidentit Ahtisari, thotë në intervistën për gazetën kombëtare “Bota sot”, ministri i Pushtetit Lokal, z.Sadri Ferati

“Bota sot”: Z. ministër për fillim a mund të na i përmendni prioritetet e ministrisë tuaj për këtë vit dhe për periudhën tuaj mandatore?

Sadri Ferati: Përveç pretendimeve tona që të punojmë, gjithë puna jonë shtrihet në të gjithë rrafshin e kompetencave që ka Ministria e Pushtetit Lokal me qëllimin më të mirë që të mbështesë komunat dhe meqenëse vetëqeverisja lokale po kalon në një reformë, reformë shumë rrënjësore. Prioritet, pra është vetë reformimi i qeverisjes lokale dhe prioritet i këtij prioriteti është pakoja e presidentit Marti Ahtisari, me që është një prej çështjeve më thelbësore nga se vetë procesi politik i definimit të statusit final të Kosovës. Pavarësia e Kosovës, në një farë forme është kusht ligjor me kryerjen e të gjitha përgatitjeve në mënyrë që menjëherë pas statusit pritët të implementohet pakoja e presidentit Ahtisari. Ne do t'i japim prioritet kësaj çështje, obligimet të cilat i ka MAPL-ja në këtë drejtim është në rrugë të mirë që t'i përmbushë. Njëkohësisht do të bashkëpunojmë edhe me komunat që ato të jenë më të gatshme që të bëjnë diçka të tillë. Krahas realizimit të këtij prioriteti, komunat njëkohësisht edhe do të ngritin kapacitetet e tyre që në këtë rast do të dëshmojnë se sa janë të afta për ta kryer këtë detyrë, por ajo është një sfidë nga se e demonstrojmë edhe vet fuqinë dhe kapacitetet në vete.

“Bota sot”: Ju keni përvojë në menaxhimin e pushtetit lokal. A mendoni se këtë përvojë tuajën të “menaxhimit lokal” mund ta shfrytëzoni edhe në nivelin qendror?

Sadri Ferati: Absolutisht, edhe kjo është kënaqësia ime, ngase kam shumë përvojë dhe e di se cilat kanë qenë nevojat e pushtetit lokal në kuptimin e përkrahjes dhe mbështetjes nga ana e ministrisë. Të gjithë atë që e kam kërkuar edhe më herët edhe nga ish-ministri Lutfi Haziri, për çka në këtë rast do t'i falënderohem për një përkrahje që na ka dhënë në përgjithësi, por edhe personalisht Kuvendit Komunal të Mitrovicës. Do të vazhdoj me këtë përvojë shumë fuqishëm që ta luajmë rolin e një mbrojtësi të interesave të qeverive lokale në raport me kabinetin qeveritar dhe kjo do të jetë kënaqësia ime në një farë forme ngase do të jetë një satisfaksion edhe i gjendjes në të cilën kemi qenë gjatë ushtrimeve të detyrave në pushtetit lokale.

“Bota sot”: Decentralizimi është një “thembër e Akilit” në Kosovë. A do të jetë ky proces edhe “mollë sherri” për të ardhmen e Kosovës. Këtu kemi parasysh komunat e reja me popullatë shumicë serbe, por edhe pjesën Veriore të Mitrovicës?

Sadri Ferati: Me këtë pyetje do të përgjigjem nga këndi i përgjegjësive dhe i kompetencave ministrorë. Vendimet janë ato që ne i dimë se si formulohen këto dhe cili është rrafshi politik që merren këto vendime rreth reformimit të pushtetit lokal dhe decentralizimit. Edhe Kosova sikur edhe gjitha vendet e Ballkanit e Evropës, do të detyrohen të reformohen dhe në kuadër të saj është edhe decentralizimi ose bartja e sa më shumë kompetencave në nivele lokale. Do të thotë në vetëqeverisje lokale. Ne si një mentalitet i ri që jemi, realisht pajtohemi edhe me dilemën që ju në pyetjen e juaj shtruat. Ky mentalitet a do të përdorë ato kompetenca për të fuqizuar ushtrimin e pushtetit në dobi të qytetarëve, që të jep më shumë kompetenca që qytetari të ketë një adresë më të shkurtër për këto çështje, që të jetë sa më afër qytetarit edhe në aspektin e menaxhimit dhe të afrimit të shërbimeve apo të keqpërdorë atë pushtet që atij i afrohet për të demonstruar komplekset ose defektet momentale. Njëjtë do të jetë edhe me qytetin e Mitrovicës. Vet qyteti i Mitrovicës si një tërësi, pra që do të shkohet nga ajo që ta fitoj statusin e qytetit dhe të administrohet në më shumë se një njësi administrative politike. Pra komuna të cilën edhe tash e quan dhe kjo është një term që edhe shpesh herë e ngatërrojnë se çfarë është qytet e çka është komunë. Nëse vërtet ajo ndodh për arsye që ne i dimë pse ajo duhet të ndodhë ngase është një vendim dhe rrjedhë edhe në pakon e Ahtisarit dhe pakoja e Ahtisatit, nuk ka fuqi që të nxirret e vendoset diçka tjetër dhe ajo është një pako dhe prandaj ajo quhet ashtu. Dhe na e kemi marrë dhe po lusim që ajo të impementohet. Me këtë rast unë po shpresoj se edhe Kosova në tërësi pas definimit të statusit politik të saj pra të shpalljes së pavarësisë, opsionet joreale që janë tani në lojë në tërësi nga se nuk janë për përdorim dhe nëse shkohet në aksionet reale të një bashkëjetese që duhet të bëjnë të gjithë qytetarët e Kosovës që të prodhohet një Kosovë, e cila pastaj krahas vendosjes në implementimin e ligjeve pozitive që janë aprovuar. Njëkohësisht do të shërohet nga gjendja momentale dhe si një trup i tillë dhe si një shoqëri do të pretendojnë që përveç stabilizim-asocimit për të përmbushur standardet konkrete në integrimet evropiane, pra del se vetëqeverisja, reforma dhe vetë decentralizimi është diçka pozitive për shoqërinë. Mirëpo ne do të kujdesemi që këtë mos ta keqpërdorë askush, pra edhe në Mitrovicën veriore që ai pushtet që i afrohet, ajo komunë që i afrohet të mos përdoret në interes të qoftë të një individi, nacionaliteti tjera e tjera. Duhet të jetë në dobi të të gjithë qytetarëve. Për atje do të kujdesemi që ne ta definojmë, normalisht ne nuk i kemi të gjithë mekanizmat e imponimit të një gjëje të tillë, por siç e dini edhe ju është paraparë, tash po i referohem vetëm Mitrovicës, nga se lokacionet tjera janë ndryshe. Mirëpo është e vërtet që Mitrovica do të jetë ai treguesi më i mirë se ka po shkon shoqëria e Kosovës. Nga se në rast se në Mitrovicë nuk funksionon mirë decentralizimi, ai do të përçohet në tërë Kosovën dhe nuk do të ketë kështu kuptimin. Atje do të jetë testi kryesorë dhe e mira është që të kemi një mbështetje të fuqishme të të gjithë faktorëve relevant që ajo të shkoj mirë, madje edhe shumë donatorë. Ajo do të matet pak a shumë edhe me atë treguesin e donacioneve dhe investimeve për një zhvillim më të fuqishëm ekonomik. Ai do të jetë një funksion paralel. Fuqizimi i vetëqeverisjes lokale bashkë me një zhvillim ekonomik. Ai i cili ato i implementon mirë dhe ai do të përfitojë më shumë dhe një investim të balancuar. Nëse është kjo kështu, unë po shpresoj se pas pavarësisë së Kosovës dhe gjithë asaj që e thash më parë serbët duhet t'i kthehen vetvetes dhe të punojnë në interesin e tyre, interes që të zhvillohen ekonomikisht, që të kenë mirëqenie sociale, mbrojtje shëndetësore, arsim të mirë sikur edhe gjithë shoqëria e Kosovës. Do të bëhen qytetarët të barabartë, do të krijojnë një vizion për një të ardhme më të mirë të vetvetes dhe do të jenë pjesë e një ndërtimi të një infrastrukture për të gjithë. Unë në këtë rast besoj që decentralizimi është pozitiv. Me rastet e tjera do të jetë një çështje që edhe pushteti qendror, por edhe gjithë qytetarët dhe përfaqësuesit civil ndërkombëtar që do të instalohen në Mitrovicë, do të shikojnë se cila do të jetë rruga që të mos lejohet të prodhohet ndonjë defekt që ka për qëllim pushtetin, qoftë i ndonjë individi apo në të drejtën e njerëzve në qasje të pronave të tyre. E

drejta e tyre që të jenë pjesëmarrës aktiv në ndërtimin e institucioneve, pastaj që të kenë qasje në ato institucione edhe në ato arsimore, shëndetësore tjera. Kjo është ajo sfida për të cilën unë pajtohem se ekziston dhe jam i prirur me besuar se gjërat do të shkojnë nga pozitivja.

“Bota sot”: Ju keni qenë kryeshef i komunës së Mitrovicës, por sigurisht se nuk keni mundur të ushtroni pushtetin në pjesën veriore qytetit. A mendoni se edhe si ministër i Pushtetit Lokal do të hasni në vështirësi në menaxhimin e pjesës veriore të qytetit të Mitrovicës, përkatësisht në komunat me shumicë etnike serbe?

Sadri Ferati: Si ish-kryeshef edhe nuk ka qenë e përshkruar ajo kompetencë që unë ta ushtrojë, nuk ka qenë ajo pa mundësi individuale ose vullnet individual, por siç dihet në një urdhëresë administrative në kuadër të Shtajnerit, ajo pjesë e qytetit është paraparë që të administrohet nga UNMIK-u si një pjesë e qytetit të Mitrovicës. Por që në këto rrethana siç dihet është paraparë që të ushtrohet dhe ne kemi bashkëpunuar në interes të qytetarëve, por gjithsesi nuk kemi qenë kompetentë të ushtrojmë ato kompetenca. Është ndryshe në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, që i ka të gjitha këto kompetenca në të gjithë territorin e Kosovës dhe është një çështje tjetër se në cilin nivel do të zhvillohet ky bashkëpunim. Kemi katër modele të ushtrimit të pushteteve lokale dhe vetëqeverisjes lokale, ajo është komuna që unë kisha me e quajti “normale”. Pra aty ku ka pasur zgjedhje të lira të vitit të kaluar në të gjitha pushtetet, asambljetë komunale dhe organet ekzekutive. Pastaj kemi modelin e refuzimit të bashkëpunimit qoftë me strukturat e UNMIK-ut apo edhe me Ministrinë e Pushtetit Lokal, siç janë komunat e pjesës veriore. Kemi administrimin e UNMIK-ut siç është Mitrovica veriore, kemi pilot njësit komunale dhe pretenduesit e disa lokaliteteve që të shndërrohen në komunë. Këto katër modele është dëshira jonë që të unifikohen. Ne kemi kompetenca, mirëpo nuk është e pritshme për momentin se ne do të kemi rezultate të dëshirueshme, ngase nuk kemi mundësi as të monitorojmë e as të një mbështetje pa bashkëpunim.

“Bota sot”: Tri prej pesë pilot-komunave tashmë janë themeluar. A do të vazhdoni edhe më tutje me këto komuna, pra me funksionalizimin e tyre në bazë të Dokumentit të Ahtisarit?

Sadri Ferati: Siç dihet themelimi i këtyre pilot-njësive komunale është kompetencë e përfaqësuesit special. Ne ju kemi drejtuar më një shkresë përfaqësuesit special dhe kemi marrë përgjigjen se ato pilot-njësi vazhdojnë në funksionimin e tyre. Ka edhe diçka të paqartë nga se ju është vazhduar mandati kryetarëve të këtyre komunave, por nuk kemi marrë përgjigjen se çka në asambljetë komunale dhe me pjesën ekzekutive. Po ashtu edhe rreth një perspektive që duhet të diskutohet me nivelet tjera se cila do të jetë perspektiva e më tutjeshme e pilot-njësive. Ndërsa përgjigja është se kjo është kompetencë e përfaqësuesit special. Ne do të vazhdojmë të ushtrojmë kompetencat tona që janë deri më tash në monitorimin dhe mbështetjen, por nuk jemi përgjegjës për të dhënë definicionin se cilat janë pilotë-njësitë dhe si do të duken ato.

“Bota sot”: A vlerësoni se zgjidhja e statusit përfundimtar të Kosovës do të reflektohet pozitivisht në punën tuaj dhe në funksionalizimin e komunave të reja të Kosovës, apo në Kosovën e Pavarur, komunat e reja serbe do të “rebelohen”?

Sadri Ferati: Absolutisht parakushti kryesor, që do të ndikoj drejtpërdrejt në rezultatet tona jo në kompetenca, por në rezultatet tona është vetë definimi i statusit. Kam atë bindje të plotë dhe nuk do të kisha shpresuar shumë në rezultate, por kisha besuar se kjo gjendje do të vazhdojë kësaj. Mendimi dhe bindja ime e thellë se do të definohet statusi politik i Kosovës me alternativën më të mirë, pra me pavarësinë e Kosovës, cilësdo formë apo cilësdo rrugë teknike të jetë ajo. Pas kësaj gjendjeje pas statusore do të jetë sfida për rezultatet shumë më

të fuqishme, por në kuptimin e arritjes së rezultateve të kësaj ministrie dhe timin personal do të jetë një pozicion absolutisht shumë më i favorshëm, nga se do të fuqizohet vet roli i ministrisë. Pastaj komunat do të jenë shumë më aktive dhe shumë më ambicioze, por edhe me detyra shumë më konkrete në përmbushjen e shumë standardeve të domosdoshme dhe respektimin e shumë ligjeve dhe kartave evropiane. Ngase i shkon edhe Kosovës që të demonstrojë sa më shpejt se përveç që është pjesë e Evropës ajo edhe e ka ndërtuar shoqërinë në standarde evropiane.

“Bota sot”: Z. ministër Ju faleminderit për intervistë!

Sadri Ferati: Jeni të mirëseardhur gjithherë dhe ju falënderoj për intervistat e juaja, gazeta juaj është një medium të cilin e çmojë shumë.

Intervistoi: Ismail Shabani

Foto: P. Prenaj

Legjenda: Ministri i Ministrisë së Pushtetit Lokal, Sadri Ferati